



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA LEZHË

Nr. 18573/1 Prot.

Lezhë, më 26.10. 2021

P / VENDIM

Nr. _____ Prot . Datë _____ 2021

“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB-NË NR.115, DATË 26.08.2020 “ PËR MIRATIMIN E LISTËS SË SUBJEKTËVE PËR FITUESE PËR GRANTE RINDËRTIMI PËR SHTËPITË INDIVIDUALE DHE BANESA NË NDËRTEZA (PALLATE) ME SHKALLË DËMTIMI DS4 DHE DS5 SIPAS ANALIZAVE TË THELLUARA TË INSTITUTIT TË NDËRTIMIT NË BASHKINË LEZHË”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2 , nenit 9, pika 1, nën-pika 1.1, shkronja “b” , nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “ Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 42, pika 1, shkronjat "b" dhe "d ", nenit 57, nenit 58 të ligjit nr. 45/2019, “ Për mbrojtjen civile", vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar dhe Aktit Nr. 09, date 16.12.2019 "Per përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.115, datë 26.08.2020 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë”,

PASI KONSTATOI SE:

Me vendimin e Këshillit të Bashkisë Lezhë nr.115, datë 26.08.2020 “ Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të institutit të ndërtimit në Bashkinë Lezhë”, në Lidhjen nr.1, gabimisht është shpallur përfitues Gjovalin Pjetër Dedgjonaj për aplikimin nr.1389/245 prot., datë 10.02.2020, kur duhej të shpallje përfitues Drande Meç Dedgjonaj, e identifikuar me nr. personal E051012700. Gjovalin Pjetër Dedgjonaj është përfaqësues me prokurë e Drande Meç Dedgjonaj dhe familjes së saj për këtë aplikim dhe

pronar i banësës së dëmtuar nga termeti i datës 26.11.2019 është Drande Meç Dedgjonaj dhe familja e saj. Për këtë arsye Kryetari i Bashkisë Lezhë i propozon Këshillit të Bashkisë Lezhë,

PËR TË VENDOSUR:

1. Miratimin e një ndryshimi në pikën 1 të Vendimit nr.115, datë 26.08.2020 “ *Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të institutit të ndërtimit në Bashkinë Lezhë*”, si më poshtë:
 - Në aplikimin me nr.1389/245 prot., datë 10.02.2020, hiqet si përfitues Gjovalin Pjetër Dedgjonaj (Nr.Rendor 80 në Qytetin Lezhë), dhe shpallët përfitues Drande Meç Dedgjonaj, e identifikuar me nr. personal E051012700.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 , të nenit 55 , të ligjit nr . 139/2015 , “ Për vetëqeverisjen vendore ”, të ndryshuar .

KRYETARI

Pjerin Ndren





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA LEZHË
KRYETARI

Nr. 18573 Prot.

Lezhë, më 26.10.2021

Lënda: Për projektvendimin “Për një ndryshim në VKB-në nr.115, datë 26.08.2020 “ Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të institutit të ndërtimit në Bashkinë Lezhë”.

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

KËTU

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2 , nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” , nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “ Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 42, pika 1, shkronjat "b" dhe "d ", nenit 57, nenit 58 të ligjit nr. 45/2019, “ Për mbrojtjen civile", vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar dhe Aktit Nr. 09, date 16.12.2019 "Per përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.115, datë 26.08.2020 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë”, Bashkia Lezhë i ka paraqitur Këshillit të Bashkisë për miratim prjokjektvendimin “Për një ndryshim në VKB-në nr.115, datë 26.08.2020 “ Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të institutit të ndërtimit në Bashkinë Lezhë”,

Nga ana e bashkisë është konstatuar se është bërë një gabim njerëzor në VKB-në nr. Nr.115, datë 26.08.2020. Në Lidhjen nr.1, gabimisht është shpallur përfitues Gjovalin Pjetër Dedgjonaj për aplikimin nr.1389/245 prot., datë 10.02.2020, kur duhej të shpallje përfitues Drande Meç Dedgjonaj, e identifikuar me nr. personal E051012700. Gjovalin Pjetër Dedgjonaj është përfaqësues me prokure e Drande Meç Dedgjonaj dhe familjes së saj për këtë aplikim dhe pronar i banesës së dëmtuar nga termeti i datës 26.11.2019 është Drande Meç Dedgjonaj dhe familja e saj. Pëfitues sipas ligjit shpallet i përfaqësuari dhe jo përfaqësuesi dhe kjo gjë ka

ndodhur për shkak të një gabimi njerëzor. Për këtë arsye i jemi drejtuar Këshillit të Bashkisë Lezhë për të miratuar një ndryshim në VKB-në nr.115, datë 26.08.2021, si më poshtë:

- Në aplikimin me nr.1389/245 prot., datë 10.02.2020, hiqet si përfitues Gjovalin Pjetër Dedgjonaj (Nr.Rendor 80 në Qytetin Lezhë), dhe shpallët përfitues Drande Meç Dedgjonaj, e identifikuar me nr. personal E051012700.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI
Pjerin Ndren

